



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300513/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandim për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për fëmijët në Shtëpinë e Foshnjës, Durrës (0-6 vjeç)

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL  
SHTETËROR**

**TIRANË**

**BASHKISË DURRËS**

**SHTËPISË SË FOSHNJËS DURRËS**

**DURRËS**

Të nderuar!

Më lejoni, që nëpërmjet këtij rekomandimi, institucioni i Avokatit të Popullit (AP) të ndajë me Ju konkluzionet përfundimtare, bazuar në inspektimin e realizuar në Shtëpinë e Foshnjës Durrës 0-6 vjeç referuar në vijim (SHFD) në zbatim të urdhrit të AP-së nr. 51, datë 24.7.2023, duke ju referuar si më poshtë vijon:

**1. Objektivat e inspektimit:**

- kontrolli i performancës në institucionet që ofrojnë shërbime të përkujdesit social për fëmijët në nevojë, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit dhe procedurave që ndjekin këto institucione;
- vlerësimi i cilësisë së punës së personelit të institucioneve të përkujdesit social;
- vlerësimi i mjedisve dhe kushteve të institucionit;
- vlerësimi social-psikologjik-shëndetësor i çdo përfituesi të shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror;
- respektimi i të drejtave të fëmijëve, në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në fuqi;
- verifikimi i mjaftueshmërisë së buxhetit të akorduar për garantimin e të drejtave të fëmijëve.

## **2. Metodologjia e monitorimit**

Për këtë inspektim janë përdorur metodat e kërkimit që konsistojnë në administrimin e një pyetësori dhe realizimin e intervistave me drejtuesin e institucionit, personelin dhe përfituesit. Grupi inspektues i AP-së i përbërë nga jurist, dhe punonjës social është fokusuar në:

- zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e këtij institucioni, informacion, i cili është hedhur në formatin standard për inspektimet e këtyre institucioneve;
- zhvillimin e intervistave me punonjësit dhe përfituesit e institucionit, për cilësinë e ofrimit të shërbimit;
- nivelin e zbatimit të paketës së akteve nënligjore dhe të legjislacionit në fuqi në kontekstin e respektimit të të drejtave të fëmijëve;
- monitorimin e mjedisve dhe kushteve të SHFD-së ku ofrohen shërbimet për fëmijët në nevojë.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i AP-së ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit dhe u lanë rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara në fund të raportit.

## **3. Organizimi dhe funksionimi i SHFD**

### **a) Profili i institucionit**

SHFD-ja është institucion publik në varësi të Bashkisë Durrës pajisur me çertifikatë regjistrimi (NIPT, K517035240) dhe licensuar në QKL (LN-3391-06-

2017), lëshuar më 13.6.2017, për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për fëmijë të grupmoshës 0-6 vjeç për një periudhë kohore pa afat. Përfituesit e shërbimit të këtij institucioni janë fëmijët jetimë biologjikë ose socialë të familjeve në pamundësi për t'u kujdesur për ta.

Kapaciteti i institucionit për akomodim është në total 40 fëmijë prej të cilëve 20 fëmijë në shërbim rezidencial dhe 20 fëmijë në shërbim ditor. Numri i stafit, sipas organikës së miratuar është 28 punonjës nga të cilët 22 punonjës (punonjës socialë, kujdestarë) në shërbim të drejtpërdrejtë të fëmijëve.

Tipologjia e shërbimit të përkujdesit social rezidencial në këtë institucion është shtëpi-familje. Bazuar në këtë tipologji shërbimi fëmijët janë të akomoduar në dy shtëpiza. Në shtëpizën e Durrësit janë 10 fëmijë dhe në shtëpizën e Shkozetit janë 11 fëmijë. Shërbimi ditor ofrohet në shtëpizën e Shkozetit në mjediset e katit të parë të godinës për familjet në nevojë.

**Misioni dhe qëllimi** i institucionit është ofrimi i shërbimit rezidencial dhe jorezidencial të përkujdesit shoqëror për fëmijët, duke siguruar mbrojtje, zhvillim dhe integrim e tyre në jetën shoqërore duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut<sup>1</sup>.

**Shërbimet që ofrohen** në SHFD janë:

- përkujdesje për mirërritjen e fëmijëve që përfshin akomodim, ushqim, veshmbathje, siguri jetese;
- shërbim psiko-social si dhe veprimtari argëtuese, integruese etj;
- edukim parashkollor;
- përkujdesje shëndetësore.

SHFD-ja ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Durrës, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, që akordon fonde nga buxheti i shtetit.

#### b) **Stafi i SHFD**

Administrimi dhe ofrimi i shërbimeve të përkujdesit social në SHFD bazuar në strukturën organike të tij përbëhet nga 28 punonjës, si dhe çdo vit kontraktohet një

---

<sup>1</sup>Regullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të shërbimit në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 vjeç Durrës miratuar nga Vangjush Dako

mjek me kohë të pjesëshme<sup>2</sup>. Referuar strukturës së institucionit përbërja e sektorit të shërbimeve sociale dhe të administrates është: 1 drejtues, 1 financiar, 1 përgjegjës sektori social, 2 specialistë sektori social (një prej të cilëve është punonjës social dhe një psikolog), 19 kujdestarë (1 nga kujdestarët kryente rolin e infermierit), 2 kuzhinierë, 1 punëtor mirëmbajtjeje, dhe 1 sanitar. Dosjet e stafit administrohen nga Bashkia Durrës dhe kopjet e tyre ndodhen në institucion. Nga kontrolli rastësor i tyre u gjendën kontrata individuale, librezat e punës, CV-ja, diplomat sipas arsimit përkatës, dëshmitë e penalitetit dhe librezat shëndetësore.

### **c) Mjediset strukturore të institucionit**

SHFD-ja ofron shërbim rezidencial dhe ditor për fëmijët në nevojë. Shërbimi ofrohet në dy godina të ndara nga njëra-tjetra me vendndodhje gjeografike një në Durrës (shtëpi private dy katëshe) dhe tjetra në Shkozë. Ndarja e godinave është realizuar për të bërë të mundur përshtatjen e mjediseve me tipologjinë e shërbimit rezidencial shtëpi-familje. Infrastruktura e godinës së SHFD-së në Shkozë është një ndërtesë e vjetër dy katëshe. Në katin e dytë të godinës është ristrukturuar një mjedis si apartament për të krijuar modelin shtëpi familje me sallon, dhoma gjumi, kuzhinë, dhoma e takimit me prindërit, tualete etj. Në katin e parë të kësaj godine ndodhen mjediset për ofrimin e shërbimit ditor, kuzhina, lavyeria dhe zyrat e stafit. Hapësirat janë të bollshme dhe funksionale në drejtim të jetesës normale për të krijuar një mjedis familjar. Mjediset e përbashkëta (salloni, kuzhina etj) dhe dhomat e gjumit, janë të mobiluara, të pajisura me produktet përkatëse elektroshtëpiake dhe hotelerike. Fëmijëve nuk ju mungonin veshëmbatjet si dhe produktet hotelerike, kjo edhe për faktin se përvec blerjeve të bëra nga institucioni kishte dhe donacione të ndryshme.

Gjatë tërmetit të nëntorit 2019, godinat kishin pasur dëmtime të lehta, të cilat ishin rikonstruktuar nga Bashkia Durrës. Pavarësisht ndërhyrjeve të kryera, përsëri në korridorët dhe disa mjedise në godinën e Shkozë u konstatua se lagështira ishte e dukshme. Sigurimi i sistemit të ngrohjes dhe freskimit në të gjitha mjediset e qendrës, në periudhën e verës dhe dimrit realizohet me kondicioner dhe ngrohës elektrik. Institucioni ka furnizim të rregullt me ujë, elektricitet, si dhe plotëson kushtet higjieno-sanitare.

---

<sup>2</sup>Urdhëri i kryeministrit nr.88, datë 25.10.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”

Siguria e fëmijëve dhe mjedisve të SHFD-së (në të dyja shtëpizat) realizohet nëpërmjet sistemit të monitorimit me kamera. Shtëpizat janë të rrethuara, me porta të mbyllura.

#### d) **Funksionimi dhe shërbimet e ofruara në institucion**

Funksionimi i brendshëm dhe organizimi i SHFD-së realizohet në mbështetje të rregullores së brendshme. Rezulton se institucioni ende funksionon me rregulloren e adresuar nga Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së në vitin 2017, të pamiratur nga ish-kryetari i Bashkisë Durrës, të evidentuar në rekomandimin e AP-së realizuar në 2017<sup>3</sup>. Ky version i rregullores në përmbajtje është i përgjithshëm, për të gjitha institucionet e përkujdesit social rezidencial për fëmijët e grupmoshës nga 0-6 vjeç dhe nuk përmban në mënyrë specifike parashikime për transformimin e funksionimit të institucionit, sipas tipologjisë së shërbimit shtëpi-familje. Mungesa e profilizimit specifik për çdo institucion të përkujdesit social në brendësi të rregullores mund të bëhet pengesë për realizimin e objektivave kryesorë të këtyre lloj institucioneve. Rregullorja nuk është e azhornuar me legjislacionin e ri të shërbimeve sociale<sup>4</sup>. Nga ana tjetër, këto ligje dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre trajtojnë dhe rregullojnë aspekte apo faza të institucionalizimit, si dhe mbështetjen apo mbrojtjen që i jepet fëmijës, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme rezidenciale. AP-ja vëren me keqardhje që rekomandimi i vitit 2017 nuk është realizuar dhe

---

<sup>3</sup><https://smpdf.org/wp-content/uploads/2021/03/Rekomandojme-marrjen-e-masave-per-permiresimin-e-trajtim-it-kushteve-dhe-mirerritjen-e-femijeve-ne-Shtepine-e-Foshnje-0-6-vjec-Durres.pdf>

<sup>4</sup>Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” Vendim nr. 578, datë 3.10.2018, i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”; Udhëzim nr. 556, datë 29.7.2019, “Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje”; Udhëzim nr. 584, datë 31.7.2019, “Për rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor”; Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”; Vendimi nr.136, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”; Vendimi nr.149, datë 13.3.2018, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”; Vendimi nr. 518, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitime të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”; Udhëzimi nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”; Vendimi nr.150, datë 20.3.2019, Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”; Udhëzim nr.394, datë 9.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”.

rregullorja e punës ka mbetur pa u përditësuar me parashikimit e reja ligjore e nënligjore në fuqi, tashmë prej shumë vitesh.

Në mjediset e institucionit janë afishuar informacione të ndryshme, si deklarata, rregullorja, të drejtat e fëmijëve, kriteret e përfitimit të shërbimit etj. Kutia e ankimit është e vendosur në një vend të dukshëm, ku janë afishur dhe procedurat e saj. Hapja e kutisë së ankimit realizohet çdo muaj me prezencën e përfaqësuesve të SHSSH, Zyra Rajonale Durrës.

Në të dyja shtëpizat (Durrës dhe Shkozet) qëndrojnë fëmijë të grupmoshave 0-6 vjeç në përputhje me tipologjinë e shërbimit për të krijuar një mjedis të ngrohtë familjar. Ky shërbim ofron një zhvillim normal të tyre, pasi që nga fëmijëria e hershme, ka një vendosje të atashimit të sigurt, sidomos tek fëmijët latantë me kujdestarët, nëpërmjet kontaktit me sy, procesit të të ushqyerit, shëtitjes etj. Përkujdesja specifike për çdo fëmijë të grupmoshës nga 0-6 vjeç krijon atmosferë të ngrohtë familjare dhe bashkëveprim ndërmjet tyre duke garantuar zhvillim psiko-social-motorik normal. Nga vëzhgimi me sy të lirë dhe bisedat e kryera me fëmijët vihet re atashimi i sigurt i fëmijëve me kujdestarët dhe njohjes nga ana e tyre e rregullave bazë për kujdesin ndaj vetes dhe shtëpisë. Çdo fëmijë kishte të personalizuar gotat, peshqirët, furçat dhe pastën e dhëmbëve. Fëmijët tregojnë me hollësi mjediset e shtëpisë dhe hapësirat e tyre personale si krevatin, raftet dhe dollapet e rrobave.

Për çdo fëmijë është hapur dosje personale. Dosjet e fëmijëve përmbanin vlerësimin e nevojave, planin e përkujdesjes, integrimin individual të fëmijëve dhe raportet periodike mbi ecurinë e zhvillimit të tyre. Dokumentet janë të hartuara nga grupi multidisiplinor i përbërë nga punonjësi social, psikologu, punonjësi përgjegjës që punon drejtpërsëdrejti me fëmijën, (kujdestar) dhe mjekja. Format i dokumentacioneve të dosjeve të fëmijëve është rekomanduar nga UNICEF-i Shqipëri në kuadër të projekteve të procesit të deinstitutionalizimit dhe është i plotësuar rregullisht dhe në të gjitha rubrikat.

Shërbimi shëndetësor ofrohet nga mjekja. Çdo fëmijë ka kartelën shëndetësore me shënimet periodike të mjekes. Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti. Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhet rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grupmoshave të përcaktuara në të. Mjekja ka hartur një regjistër ku regjistron çdo vizitë për secilin fëmijë. Sa u takon vizitave shëndetësore, vizitat bëhen në mënyrë periodike dhe në raste emergjence. Çdo fëmijë deri në moshën 1 vjeçare kontrollohet çdo muaj, fëmijët e moshës 12-24 muaj vizitohen 1 herë në tre muaj dhe nga moshë 2-6 vjeç bëhet një vizitë çdo 6 muaj. Të gjitha kontrollet

periodike mjekësore dhe ecuria e zhvillimit psikomotor të fëmijëve është e dokumentuar.

*Proçesi i edukimit dhe veprimtaritë argëtuese* janë të dokumentuara në planet vjetore dhe mujore të stafit social të institucionit, të miratuara nga drejtuesi i tij. Fëmijët ndjekin programin mësimor të klasës së parë në shkollën 9-vjeçare “Nënë Tereza”. Ndërsa, fëmijët e grupmoshës 3-5 vjeç frekuentojnë kopshtin “Hasan Koçi” dhe “Foto Monobeu”. Bazuar në planet mujore të veprimtarive argëtuese zhvillohen aktivitete të ndryshme, festimi i ditëlindjeve, zhvillimi i lojërave argëtuese në këndin e lojërave të vendosur pranë institucionit, lojra zbavitëse social-edukative në mjediset e shtëpizave ku fëmijët vizatojnë, ngjyrosin, angazhohen në lojra me plastelinë etj.

*Kuota ditore e ushqimit*, bazuar në kontrollin e dokumentacioneve (menuja javore e ushqimit) dhe monitorimin e kuzhinës, AP-ja konstatoi se menuja është hartuar dhe miratuar nga grupi multidisiplinar (përgjegjësja e sektorit social, kryekujdestarja, mjeku dhe përgjegjësi i sektorit të administratës). Fëmijët latant 0-1 vjeç kanë të hartuar menu deri në 5 vakte në përputhje me moshën e tyre. Për fëmijët e grupmoshës më të rritur 2-6 vjeç menuja ushqimore është e larmishme me vakte ushqimore që përmbajnë perime të stinës. Kampionët ushqimorë janë të ruajtur në mjedise të përshtatshme dhe sipas vakteve. Kuzhina e institucionit gatuate për fëmijët në shërbim ditor. Për fëmijët rezidentë përgatitja e ushqimit kryhej në shtëpizat e tyre. Kuzhinierja ishte e pajisur me librezë shëndetësore.

Bazuar në udhëzimin e kuotës ushqimore të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rishikuar në vitin 2018, masa e kuotës ushqimore për fëmijët e vendosur në institucionet e përkujdesjes 0–3 vjeç është në 360 lekë, për fëmijët e grup-moshës 4–5 vjeç, të vendosur në institucionet e përkujdesjes, në masën 400 lekë<sup>5</sup>.

Gjatë intervistës së realizuar me stafin e SHFD-së, grupi inspektues i AP-së u njoh me draft-urdhrin për një ushqyerje të shëndetshme me qëllim garantimin e një zhvillimi normal tek fëmijët, të dërguar nga Shërbimi Social Shtetëror, si një udhërrëfyes i qartë për të gjithë personelin e institucioneve të përkujdesit social që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë, duke pasqyruar informacione të detajuara mbi ushqyerjen e shëndetshme të shoqëruara me menutë përkatëse, llojshmërinë e ushqimeve në përputhje me moshën, stinët etj. Megjithatë, në përmbajtje të këtij draft-urdhëri nuk ishte e parashikuar masa e kuotës ushqimore në vlerë monetare, bazuar në indeksimin e çmimeve të konsumit, sipas rekomandimit të adresuar nga AP-ja. Bazuar në një

---

<sup>5</sup>Udhëzimi nr.689, datë 2.10.2018 për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror

inspektim të kryer në Qendrën e Zhvillimit Shkodër, AP-ja ka konstatuar problematikën e indeksimit të çmimeve të konsumit (shporta bazë e ushqimeve të konsumit) për periudhën kohore 2018-2022, (viti 2018, është periudha në të cilën është miratuar udhëzimi i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqim, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror) duke adresuar rekomandimin për marrjen e masave për indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit social adresuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)<sup>6</sup>. Në përgjigjen zyrtare të MSHMS-së lidhur me këtë rekomandim, AP-ja është informuar se pranë këtij institucioni është ngritur grupi i punës, i cili ka si qëllim përcaktimin e normës ushqimore për qendrat rezidenciale për fëmijë. Përcaktimi i normës do të sjellë rishikimin e kuotës ushqimore për të bërë të mundur indeksimin e kësaj kuote në përputhje me ndryshimet e normave të inflacionit<sup>7</sup>.

Sa më sipër, është ngritur grupi i punës nga MSHMS-ja për përcaktimin e normës ushqimore për qendrat rezidenciale të cilët kanë hartuar draft-udhëzuesin, por ende nuk është përcaktuar masa e kuotës ushqimore bazuar në ndryshimet e normave të inflacionit.

Pavarësisht kësaj pune të nisur nga MSHMS për ndryshimin e masës së kuotës ushqimore, me fokus ushqyerjen e shëndetshme, AP-ja konstaton se ende nuk kemi një akt nënligjor për miratimin e kuotës ushqimore për përfituesit në institucionet e përkujdesit shoqëror. Periudha kohore e zgjatur (prej më shumë se shtatë muaj) tregon mospërbushjen e rekomandimit të adresuar nga AP-ja.

*Mbështetja financiare e veprimtarisë së SHFD* realizohet nga fondet e buxhetit të shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Fondi i parashikuar dhe realizuar në dy vitet e fundit është si vijon:

- plan-fakti për vitin 2022 për zërat: paga, shpërblime, sigurime shoqërore, shpenzime operative ka qënë planifikuar në shumën prej 26 880 000 lekë (njëzet e gjashtë million e tetëqind e tetëdhjetë mijë lekë) dhe realizimi i planit është në shumën prej 26 828 170 lekë (njëzetë e gjashtë million e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë lekë) me përqindje fondi është realizuar me 99.81%;

---

<sup>6</sup> Shkresa zyrtare me nr.K5/I1-4 prot., datë 17.6.2022 të institucionit të Avokatit të Popullit

<sup>7</sup> Shkresa zyrtare me nr.3470/1, datë 13.9.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



- plan-fakti për vitin 2023 për zërat: paga, shpërblime, sigurime shoqërore, shpenzime operative ka qënë në shumën 29 685 000 lekë (njëzet e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë mijë lekë) dhe realizimi i fondit për periudhën janar-prill 2023 është në shumën prej 8 584 230 lekë (tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tridhjetë lekë).

Në krahasim me vitin 2022, konstatohet një rritje në shumën prej 2 805 000 lekë (dy milion e tetëqind e pesë mijë lekë) nga fondet e buxhetit të shtetit. SHFD-ja, megjithëse ka varësi të dyfishtë institucionale nga Bashkia Durrës dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nuk ka marrë asnjë mbështetje financiare nga buxheti i Bashkisë Durrës. Nga fondet e buxhetit të bashkisë mbështetja e fundit financiarë është realizuar në vitin 2017, në shumën prej 700.000 lekësh për mirëmbajtjen e shtëpizave.

*Marrëveshjet e bashkëpunimit me organet të tjera publike dhe jo publike*<sup>8</sup>: SHFD-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën Nisma për Ndryshim Shoqëror-ARSIS për një periudhë kohore nga data 5 shkurt 2020 deri në datën 30 tetor 2020. Kjo marrëveshje është nënshkruar në kuadër të procesit të de-institucionalizimit (De-I)<sup>9</sup>. MSHMS-ja me mbështetjen e UNICEF-it dhe Save the Children është në proces të avancimit gradual dhe të plotë të De-I të fëmijëve nga të gjitha institucionet publike të përkujdesit shoqëror nëpërmjet përfundimit të mbështetjes ndaj familjes, mundësive të ribashkimit, si dhe kujdesit alternative për fëmijët. Faza e parë në këtë drejtim ka konsistuar në vlerësimin e plotë të fëmijëve të vendosur në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror public, mbështetur nga UNICEF-i në partneritet me ARSIS dhe Save the Children, i cili ka përfunduar si proces në 2020 (e përmendur më sipër për SHFD). Faza e dytë e këtij procesi konsiston në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës ndërmjet SHFD-së si institucion i përkujdesit shoqëror dhe ARSIS-it për planifikimin e ribashkimit mes fëmijëve dhe familjeve, gjetjen e alternativave të tjera si kujdestari alternative me/pa lidhje gjaku dhe transformimit të shërbimeve nga rezidenciale në shërbime për fuqizimin e familjeve.

Ky proces kërkon angazhimin e Bashkisë Durrës për të ngritur shërbime të reja (shërbim mbështetës për fëmijën dhe familjen, kujdes alternativ profesional) dhe njëkohësisht mbështetjen në nivel qendror për pilotimin e këtyre modeleve të reja,

<sup>8</sup>Marrëveshje bashkëpunimi, datë 10.3.2020 ndërmjet Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës, Institucionit të Përkujdesit Shoqëror, Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç Durrës dhe Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

<sup>9</sup>Vendimi nr.706, datë 9.9.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të De-institucionalizimit, 2020-2022 dhe planit të veprimit për zbatimin e tij”.

kostimin dhe ngritjen e mekanizmave për realizimin e tyre në mënyrë të unifikuar në të gjitha bashkitë (bashkitë ku janë të vendosura IPSH-të dhe jo vetëm).

Monitorimi i standardeve në këtë institucion kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHS) dhe Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për periudhën kohore 2021-2022, janë kryer dy monitorime, në vitin 2021 është realizuar monitorimi nga SHSSH-ja dhe në vitin 2022 është inspektuar nga ISHPSHS-ja.

### **1. Vlerësimi sasior dhe dinamika e lëvizjes së përfituesve të qendrës**

Kapaciteti i SHFD-së është 20 fëmijë në shërbim rezidencial dhe 20 fëmijë në shërbim ditor. Aktualisht ky institucion ofron shërbime të përkujdesit social për 21 fëmijë në shërbim rezidencial prej të cilëve 13 janë meshkuj dhe 8 femra dhe 17 fëmijë në shërbim ditor prej të cilëve 5 janë meshkuj dhe 12 femra. Gjatë kryerjes së inspektimit, AP-ja konstatoi se ishin 9 fëmijë në shërbim ditor. Bazuar në të dhënat statistikore të përfituesëve nga 21 fëmijë të grupmoshës 0-6 vjeç (numri total i fëmijëve në shërbim rezidencial), 9 fëmijë janë 0-3 vjeç dhe 12 fëmijë 3-7 vjeç. Nga numri total i fëmijëve 3 fëmijë janë të komunitetit egjiptian dhe 3 të komunitetit rom.

Evidencat statistikore mbi situatën sociale të fëmijëve rezidentë në këtë institucion për periudhën janar-prill 2023, pasqyrojnë se nga 19 fëmijë që kanë qënë në shërbim rezidencial në këtë periudhë, 13 fëmijë kanë pasur interesim dhe 6 fëmijë kanë qënë pa interesim, ndërkohë që nuk ka asnjë fëmijë jetim biologjik. Pranimi i fëmijëve në SHFD është kryer me vendim të Shërbimit Social Shtetëror (8 fëmijë) dhe me vendime të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) të Bashkisë Durrës (14 fëmijë), si raste emergjente. Për 6-mujorin e parë të vitit 2023, AP-ja konstatoi se është birësuar një fëmijë dhe janë në proces birësimi 3 fëmijë. Nga numri total, sipas grupmoshës, 6 fëmijë janë 0-3 vjeç, 12 fëmijë 3-6 vjeç dhe 1 fëmijë është 7 vjeç.

Bazuar në të dhënat e sipërcituara, krahasur me një muaj më vonë (periudhë kur është kryer inspektimi nga AP-ja) **dinamika e lëvizjes së përfituesit të qendrës** rezulton me 2 pranime të reja, fëmijë të grupmoshës 0-1 vjeç, raste në situatë emergjente të referuar nga GTN-ja.

Për periudhën kohore 2017-2023, bazuar në rekomandimet e AP-së<sup>10</sup>, rezultatet e monitorimit të SHSSH-së<sup>11</sup> dhe rezultatet e inspektimit të ISHPSHS-së<sup>12</sup> numri total i fëmijëve që marrin shërbime është si vijon:

- 20 fëmijë në shërbim rezidencial në vitin 2017;
- 21 fëmijë në shërbim rezidencial në vitin 2021;
- 15 fëmijë në shërbim rezidencial në vitin 2022;
- 21 fëmijë në shërbim rezidencial në vitin 2023.

Bazuar në të dhënat e mësipërme dhe në përmbushje të treguesëve të planit të De-I, numri i fëmijëve në institucionin e përkujdesit shoqëror, SHFD, nuk është ulur. Kjo, referuar vendimit nr.706, datë 9.9.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të De-institucionalizimit, 2020-2022 dhe planit të veprimit për zbatimin e tij”. Nga informacioni që AP-ja disponon, informacion zyrtar dërguar AP-së me shkresë zyrtare me nr.3470/1 prot., datë 13.9.2022 të MSHMS, bazuar në rekomandimin e adresuar për përmirësimin e shërbimeve shoqërore në Qendrën e Zhvillimit Shkodër zbatimi i planit të De-I është shtyrë deri në vitin 2023. Procesi i monitorimit të planit të De-I kryhet nga Komiteti Drejtues për Deinstitutionalizimin i ngritur me Urdhërin nr.548 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022”<sup>13</sup>.

Shtyrja e afatit kohor për zbatimin e planit të deinstitutionalizimit është element që tregon vështirësinë e këtij procesi, prandaj angazhimi institucional, si në nivel qendror dhe vendor me qëllim uljen e numrit të fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror, konkretisht të fëmijëve në SHDF duhet të fokusohet në mbështetjen që strukturat në nivel qendror duhet t’u japin strukturave në nivel vendor, për të bërë të mundur ngritjen e shërbimit të kujdestarisë së përkohshme në këtë bashki.

AP-ja rithekson që sistemi i mbrojtjes sociale për identifikimin, vlerësimin, përfshirjen dhe integrimin e fëmijëve në jetën shoqërore, të jetë i bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Referuar pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga organet e administratës shtetërore.

---

<sup>10</sup><https://smpdf.org/ep-content/uploads/2021/03/Rekomandojme-marrjen-e-masave-per-permiresimin-e-trajtimit-kushteve-dhe-mirerritjen-e-femijeve-ne-Shtepine-e-Foshnjes-0-6-vjec-Durres.pdf>

<sup>11</sup>Shkresa zyrtare me nr.1050/1 prot., datë 3.6.2021 e SHSSH

<sup>12</sup>Shkresa zyrtare me nr.993 prot., datë 16.5.2022 e SHSSH

<sup>13</sup> Shkresa zyrtare me nr.3470/1 prot., datë 13.9.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në këtë kuptim, në frymën e legjislacionit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve dhe të shërbimeve sociale, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **R E K O M A N D O N ;**

- Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ti vënë në dispozicion Avokatit të Popullit raportin e monitorimit mbi zbatimin e planit të deinstitucionalizimit për vitin 2022.
- Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përmirësimin e masës së kuotës ushqimore, bazuar në ndryshimet e normave të inflacionit, për shpenzimet ditore të ushqimeve të fëmijëve përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Marrjen e masave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Durrës për ngritjen e shërbimit të kujdestarisë së përkohshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Marrjen e masave të menjëhershme nga Shtëpia e Fëmijës Durrës 0-6 vjeç në bashkëpunim dhe bashkërendim të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkinë Durrës për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të re të institucionit në frymën e planit të deinstitucionalizimit duke e azhurnuar me legjislacionin e ri të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së fëmijës.
- Marrjen e masave nga Bashkia Durrës për të mbështetur financiarisht Shtëpinë e Foshnjës Durrës (0-6 vjeç) për të bërë të mundur rikonstrukcionin e pjesëve me lagështirë të godinës së institucionit.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore,

për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

**K O M I S I O N E R**

**OLTA ALIAJ**